

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME DY ORTAK
"DENTI SOLARI" SHPK

Sot me daten 01.05.2024(dymijë e njëzet e katër), me ortakët themelues :

- **Z. Donato Sava** , shtetas shqiptar , i datëlindjes 14.01.1992, lindur në Durrës, dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. Leternjoftimi/karte J20114076U.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "P ër Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " DENTI SOLARI" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " DENTI SOLARI" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Durres Kati i pare, ndertese me siperfaqe 116 m2, Vertetim proniesie nr 52, dt 22.05.2023 te ZRPP Durres, Lagjja nr 4,Bulevardi Kryesor,Durres.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e: Sherbime stomatologjike, tregti produktesh te ndryshme kozmetike.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë " DENTI SOLARI"është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

- 1. Z. Donato Sava zotëron 1 kuotë baraz me 100% të kapitalit.**


Donato Sava

NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Donato Sava i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8
NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9
LIKUJDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET



Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË
"DENTI SOLARI" SH.P.K**

Donato Sava

Donato Sava
Sava